



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM

DATË 25.03.2019

“Mbi korigjimin e Vendimit Nr. 118, Datë 21.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Përparim Hasa”

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Pamela Qirko	Anëtare
Etleđa Çiftja	Relatore

Bazuar në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Trupi gjykues u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatores së çështjes znj. Etleđa Çiftja, për korigjimin e gabimit material në Vendimin Nr. 118, Datë 21.03.2019, të subjektit të rivlerësimit Përparim Hasa:

Në vendimin Nr. 118, Datë 21.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në paragrafin **II ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**; pika 11 e tij, është bërë një gabim material është shkruar “Neni 164, pika 5, e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “ *Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës*”, ndërkohë duhet të jetë “Neni 64, pika 5, e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “ *Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës*”.

Trupi pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi material,

V E N D O S I:

1. Ndrejten e gabimit material në paragrafin **II ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**; pika 11 e tij, është bërë një gabim material është shkruar “Neni 164, pika 5, e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “ Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës”, ndërkohë duhet të jetë “Neni 64, pika 5, e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “ Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.
3. Vendimi i korigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela Qirko

Lulzim Hamitaj

Etleda Çiftja

Anëtare

Kryesues

Relatore

Sekretare gjyqesore
Olsida Goxhaj